



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 1677/prot.

Tiranë, më 18.05.2020

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1499, datë 10.09.2010.

SHOQËRISË “MAJA E DRENIT” SH.P.K
Godina Një Katëshe, Pranë Galerisë, Cëruje, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Maja e Drenit” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1499, datë 10.09.2010, për mineral krom, në objektin “Maja e Drenit”, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.1243, datë 11.02.2020, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.1627, datë 13.02.2020, është propozuar revokimi i lejes shfrytëzimit nr.1499, datë 10.09.2010, për mineral krom, në objektin “Maja e Drenit”, Bashkia Klos, Qarku Dibër, sepse nuk keni paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2019, duke mos respektuar kërkesat e nenit 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në germën “c” e germën “ç” të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1499, datë 10.09.2010, për mineral krom, në objektin “Maja e Drenit”, Bashkia Klos, Qarku Dibër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1499, datë 10.09.2010, për mineral krom, në objektin “Maja e Drenit”, Bashkia Klos, Qarku Dibër”.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

